

VENDIM
Nr.155, datë 18.3.2004

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.594, DATË 28.8.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË KONCESIONIT TË FORMËS
"ROT", NDËRMJET MINISTRISË SË INDUSTRISË DHE ENERGJETIKËS E MINISTRISË
SË EKONOMISË DHE SHOQËRISË "KURUM INTERNACIONAL" SHPK, TIRANË,
PËR FABRIKËN E OKSIGJENIT NË ELBASAN"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7 e 9 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës dhe të Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Aneksi I i Marrëveshjes së koncesionit të formës "ROT", ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës e Ministrisë së Ekonomisë dhe shoqërisë "Kurum Internacional" sh.p.k., Tiranë, për fabrikën e oksigjenit në Elbasan, miratuar me vendimin nr.594, datë 28.8.2003 të Këshillit të Ministrave, ndryshon dhe zëvendësohet me aneksin I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministri i Industrisë dhe i Energjetikës dhe Ministri i Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

ANEKSI I

Planimetria e fabrikës së oksigjenit Elbasan

Sipërfaqet kryesore:

Sipërfaqja e përgjithshme	30 162,50 m ²
---------------------------	--------------------------

Sipërfaqe të lira	16 658,46 m ²
-------------------	--------------------------

Rrugë e sheshe të asfaltuara	4 303 m ²
------------------------------	----------------------

Sipërfaqja e përgjithshme e objekteve	9 201,04 m ²
---------------------------------------	-------------------------

Dimensionet e kufirit teknologjik të fabrikës të jepen në genplan

Kufizimet:

Nga veriu	Rrugë dhe tokë e papunuar
-----------	---------------------------

Nga jugu	Tokë e papunuar
----------	-----------------

Nga lindja	Përroi i Kushes
------------	-----------------

Nga perëndimi	Objekte të TEC-it
---------------	-------------------

Fabrika e oksigjenit sh.a. (objektet)

1. Freskorja

2. Stacioni i pompave

3. Depo e perlitit

4. Magazina rikupero

5. Mensa

6. Depo e vajit

7. Godina e administratës

8. Ambiente të shërbimit mekanik

9. Reparti i bombolave

10. Dushe dhe garderoba

11. Tri sfera të depozitimit të oksigjenit

12. Stacioni i reduktimit
13. Dy kullat me kapacitet 3200 Nmk
14. Salla e kompresorëve
15. Nënstacioni
16. Ambiente pune
17. Linja e tubacioneve teknologjike
18. Linjat e tensionit që lidhen me sistemin e energjisë kombëtare
19. Shtesa e mbushjes së bombolave
20. Dhoma e dezurnit dhe e zhveshjes

Shënim. Bashkëngjitur paraqesim genplanin e fabrikës për koncesion.

- Kullat 6800 Nmk i jepen në ruajtje firmës "Kurum International", për një periudhë 3-vjeçare.

Në fund të kësaj periudhe firma "Kurum International" duhet të paraqesë planbiznesin për ristrukturimin e tyre, në të kundërt do t'i kthehen OSHA-së.